



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA RREGULLATORE PËR UJESJELLËS DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODOVOD I OTPAD
WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE



Për: z. Skender Bublaku, Kryeshef Ekzekutiv KRU "Prishtina" sh. a Prishtine
Cc: z. Ejup Hashani, Kryetar i Bordit të Drejtoreve

Nga: Raif Preteni, Drejtor i ZRRUM

Prishtinë, 31 dhjetor 2010

Lënda: Tarifat e Shërbimit të Ujësjellësit dhe Kanalizimit për Vitin 2011 dñe taksat e kyçes.



REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	ZYRA RREGULLATORE PËR UJESJELLËS DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODOVOD I OTPAD	WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE
Nr. prot./Prot. Br./Prot. No. 185/10	
Njësi/Jednica/Unit DFR	
Nr. shkres./Upis. Br./Req. No.	
Dati/Datum/Date 31/12/2010	
PRISHTINE - PRISTINA - PRISHTINA	

Të nderuar,

Të bashkangjitur në ét shkresë do të gjeni Vendimin për fillimin e aplikimit të tarifave të shërbimit për vitin 2011 nga procesi afatmesëm rregulatorë 2009-2011 dhe Plotësimin UTSH-ve të datës 31 dhjetor 2008 e cila ka të bëjë me Shtojcën 1. Lista e tarifave të shërbimit, pika 2. Taksa për shërbimet e kyçes me të cilën janë përkufizuar shumat e taksave të tillë sipas shërbimeve të ujësjellësit dhe atë të grumbullimit të ujërave të zeza.

Në pajtim me kompetencat, përgjegjësitë, kornizën ligjore dhe rregulatorë në fuqi, Ligji Nr. 03/L-086, të datës 13 qershor 2008, Mbi Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49, për Veprimtaritë e Shërbimeve të Ujësjellësve, Kanalizimeve dhe të Mbeturinave dhe të Rregullës R-02/UeK, të datës 12.08.2008, Për Përcaktim të Tarifave të Shërbimit për Shërbimet e Ujësjellësit, Ujërave të zeza, dhe të Furnizimit të Ujit me Shumicë në Kosovë, Politikave tarifore për shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizim të dhjetorit 2007, pika 3.5 Mbulimi i kostove dhe pika 4.2. Rishikimi i përkohshëm periodik i tarifave), ZRRUM ka rishikuar tarifat e shërbimit të përcaktuara në fund të vitit 2008 për vitin 2011 nga periudha rregulatorë 2009-2011.

Nga monitorimi i rregullt i efekteve të dala nga tarifat e paracaktuara dy vite më parë të procesit tariforë 2009-2010, nga procesit tariforë tre vjeçar (2009-2011) mund të konstatojmë se nuk janë realizuar pritet tona, të kompanive dhe as të palëve tjera të interesit të lidhura më këto dy shërbime për kompanitë e licencuara nga ky rregulator.

Nga analizat e bëra periodike dhe një vjeçare të parametrave operativ, financiar, dhe në veçanti ata të investimeve kapitale të realizuara gjatë vitit 2009 dhe nëntë (9) mujorit të parë të vitit 2010, mund të konstatojmë se kompanitë në përgjithësi kanë dështuar në përmbushjen e objektivave të përcaktuara për vitin 2010 nga procesi rregulatorë 2009-2011, me përjashtim të shtimit të numrit të konsumatorëve të riq.

ZRRUM gjetjet e veta gjatë monitorimit të treguesve të marrë nga kompanitë i ka publikuar në katër (4) raporte periodike, dy gjatë vitit 2009 dhe dy gjatë vitit 2010 dhe të një raporti vjetor të përmbyllur për vitin 2009.

Me përbajtjen e tyre janë njoftuar kompanitë dhe palët tjera të interesit dhe janë diskutuar gjetjet e tillë në takimit e ndërsjella, duke nxjerr në pah gjetjet dhe arsyet e mos përmbushjes së tyre.

Nga diskutimet e bëra kemi konkluduar se sikurse gjatë vitit 2009 edhe gjatë nëntë mujorit të parë të vitit 2010 KRU-të kanë dështuar në përmbushjen e objektivave të përcaktuar me procesin

të kësaj periudhe kohore, ZRRUM ka shprehur shqetësimin e vet, në takimet tona të përbashkëta me Ju dhe me palët tjera të interesit për ngecjet në përbushjet e objektivave të përcaktuara me procesin e fundit rregulator për të gjitha KRU-të, duke kërkuar angazhim të shtuar për arritjen e caqeve të përcaktuara me procesin tarifor edhe të vitit 2010.

Megjithatë, edhe përkundër paralajmërimeve të rregullta, angazhimet tuaja kanë qenë të pamjaftueshme dhe nuk është arritur që të ndryshohen trendet e pakënaqshme, dhe si rezultat i kësaj treguesit kryesorë të cilët përcaktojnë përfomancën tuaj kanë mbetur të pa përbushur, për çka ZRRUM shpreh brengën e vet.

Megjithatë, ZRRUM ka marrë parasysh arsyetimet e shprehura nga KRU-të dhe konstatime e përgjithshme për vështirësitë që e kanë përcjell këtë sektor edhe gjatë vitit 2010 dhe duke u bazuar në:

- a. Rrethanat e përgjithshme të afarizmit në vend;
- b. Mungesën e mbështetjes efikase nga mekanizmat shtetëror në ngritjen e shkallës së arkëtimit;
- c. Moszgjidhen e problemit të rasteve sociale dhe problemit të mospagesës nga minoriteti serb;
- d. Shkalla e lartë e inflacionit në periudhën e shikuar nëntor 2009- nëntor 2010 prej 6.2%,
- e. Tendencat e paralajmëruara për ngritjen e kostove kryesore të prodhimit të ujit sikurse janë energjia elektrike gjatë vitit 2011,
- f. Qëndrimin e konsulentëve tonë (IPA-s) dhe grupimeve të tjera të konsulentëve nëpër KRU për mos ndërhyrje në procesin e rregulatorë të tarifave të përcaktuara për vitin 2010, etj.

ZRRUM, ka vendos që tarifat e shërbimit të përcaktuara me UTSH-ët e lëshuar me 31 dhjetor 2008 për procesin rregulatorë 2009-2011 të mbeten ashtu siç janë përcaktuar, pra të mos ndryshohen dhe nga: një (1) janari 2011 gjerë me 31 dhjetor 2011 të aplikohen të gjitha tarifat e përcaktuar me UTSH-ët e fundit.

Dëshirojmë të theksojmë se edhe gjatë vitit 2011, ZRRUM do të vazhdojë të monitorojë ngushtë përbushjen e caqeve të përcaktuara me procesin rregulatorë për vitin vijues dhe atë të përmbyllur 2010 për çka do të publikohen raporte të veçanta vjetore dhe periodike,

Në rast të mos përbushjes së objektivave të përcaktuara edhe gjatë vitit 2011, ZRRUM mund të rivlerësojë tarifat e procesit të ardhshëm rregulatorë duke i zbrit të njëjtat në proporcion me shkallën e mos realizimit të investimeve të planifikuar gjatë procesit rregulatorë 2009-2011, për të cilat janë ngarkuar konsumatorët pa të drejtë.

ZRRUM nuk do të tolerojë më as që në emër të rrethanave të vështira të pësojnë investimet kapitale të nevojshme në sistemet e ujësjellësit dhe kanalizimit, me çka do të ngritej/ulej vlera e aseteve në kompani, me çka do të përmirësohej edhe niveli i shërbimeve ndaj konsumatorëve.

Kërkojmë nga stafet menaxheriale të KRU-ve që në bashkëpunim dhe me mbështetjen e institucioneve kompetente, të angazhohen maksimalisht në realizimin e objektivave të përcaktuara për vitin 2011, sepse në rast të dështimit të serishëm mund të ketë reperkusione pasuese gjatë procesit të ardhshëm tariforë 2012-2014, dhe përfektet negative që mund të rrjedhin përgjegjëse do të janë KRU-të.

Në përputhje me kapitullin 9. Prezantimi dhe Publikimi i Tarifave të Shërbimit, nen 25, pika 25.1 dhe 25.2, duhet të bëjnë publikimin e tarifave të tillë sipas Rregullës ZRRUM R-02/UeK.

Me respekt